



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 22, datë 9.10.2014

PËR

**“DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I TIRANËS
MICHAEL D. GRANOFF, KRYETAR I BORDIT TË DREJTORËVE TË FONDIT
SHQIPTARO - AMERIKAN TË NDËRMARRJEVE DHE FONDACIONIT SHQIPTARO
- AMERIKAN TË ZHVILLIMIT”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim Relacionin “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Tiranës, Michael D. Granoff, Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Fondit Shqiptaro - Amerikan të Ndërmarrjeve dhe Fondacionit Shqiptaro - Amerikan të Zhvillimit, si dhe mbështetur ne nenin 7, pika 2, nenin 8/VII, shkronja “a” dhe nenit 32, shkronja “m” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar);

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Tiranës Michael D. Granoff, Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Fondit Shqiptaro - Amerikan të Ndërmarrjeve dhe Fondacionit Shqiptaro - Amerikan të Zhvillimit, me motivacionin:

“Për kontributin e rëndësishëm të tij në zhvillimin e projekteve të Fondacionit Shqiptaro - Amerikan për Zhvillim, të cilat kanë synuar transformimin e shumë zonave të Tiranës, në qendra të fuqishme dhe moderne për sipërmarrësit dhe modelet e biznesit, si dhe për mbrojtjen e mëtejshme dhe zhvillimin e historisë së pasur të Tiranës dhe trashëgimisë kulturore”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI